



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:005768

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05729448

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.121/18

GJYKATA THEMELORE PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit A. B. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.173/18 të datës 23.02.2018 për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 të KPRK-së, dhe veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së(04/L-082), në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.05.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Lumturije Hoxha, dhe të pandehurit A. B., të njëjtën ditë shpalli dhe me datë 24.05.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

A. B. i lindur me në Pejë, ku edhe banon, rr “R.” nr.96, i atësisë dhe amësisë e vajzërisë, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë për momentin – punon kohë pas kohe me babain, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon telefonin nr. 044/...-..., i martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

- I. Më dt. 29.12.2028, rreth orës 13:50, në rr..... Pejë, pikërisht tek lokali “.....”, afër stacionit të autobusëve me dashje dhe me mjet të përshtatshëm të cilin mund të shkaktohet lëndimi i rëndë trupor i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit të mitur Ç.K. në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të mëhershme mes tyre fillon një përleshje ku e sulmojnë fizikisht njeri tjetrin me çrast i pandehuri A.e godet me thikë

të dëmtuarin të mitur Ç.K. në dorën e majtë duke iu shkaktuar kështu lëndime trupore.

- me këtë ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 188 par. 2 të KPRK-së (04/L-082).

II. Më dt. 29.12.2028, rreth orës 13:50, në rr..... Pejë, pikërisht tek lokali “.....”, afër stacionit të autobusëve me dashje e dëmton pasurin e të dëmtuarit Luan Kastrati, në atë mënyrë që pas një përleshje në mes të pandehurit A. dhe të miturve R.K, D.K, dhe B.K. të cilët pasi e thërrasin me telefon axhën e tyre të dëmtuarin L. K. që ti marr në vendin e sipërshtënuar i njëjti shkon aty me veturën e tij G.. 2 që ti marrë dhe ti largoj nga ty dhe pasi të njëjtit arrin të yjnë në atë veturë, i pandehuri A. me një thikë godet pjesën e përparme dhe xhamin e pasëm nga ana e shoferit të veturës prone e të dëmtuarit L.

- me çka ka kryer veprën penale “Asgjësimit apo dëmtimit të pasurisë” nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së(04/L-082).

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69, 70 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurit A. B. i shqipton:

- Për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
- Për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

II. Të pandehurit i përcaktohet dënimi unik DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, i cili dënim KUSHTËZOHET, nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen veprën tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- III. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me detyrim.
- IV. Konfiskohet thika dhe boksi i hekurit të cilat kanë qenë objekt i kryerjes së kësaj veprë penale.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 23.02.2018 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.173/18 kundër të pandehurit A. B. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 të KPRK-së, dhe veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së (04/L-082).

Kjo gjykatë me datë 16.05.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Lumturije Hoxha, i pandehuri A. B. ndërsa ka munguar i dëmtuari Luan Kastrati dhe përfaqësuesi sipas autorizimit av. Gëzim Kollqaku, edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, e në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprat penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit deklaroi “ Pasi që i pandehuri pranoj fajësinë e ky pranimi i fajësisë gjenë mbështetjen në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tersi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit si dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin pranimin e fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese”.

I pandehuri A. B. deklaroi “ Unë këta persona nuk i kam njohur më herët, ata kanë pas problem me dikon tjetër e unë jam gjendur aty, pas këtij rasti unë nuk kam pas probleme me ta, këtë djalë e kam pa dhe jemi përshëndetur dhe me vjen shumë keq që ka ndodhë ky rast, tash i kam tejkaluar këto probleme, jam martuar e kam përfunduar vuajtjen e dënimit për vepra tjetër dhe nuk dëshiroj ma te kem probleme dhe kam nevojë pak a shumë ta marr jetën në duar të mia, ndihem shumë i penduar për jetën e kaluar që kam bo”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69,70 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale me të rendë për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim deri në tre (3) vjet e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim unik për dy vepra penale, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata të pandehurit i shqiptoj dënim për të dy veprat penal se dhe atë për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

Si rrjedhë në kuptim të nenit 76 par.2 pika 2.2. të KPRK-së të pandehurit i shqiptoj dënim unik, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimeve gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kushtëzues ndaj të pandehurit A. B. do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikojë në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim dhe gjëbë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandalojë të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kushtëzues në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kushtëzim mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale me tërësi që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim deri në tre (3) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit A. B. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e thikës dhe boks i hekurit të cilat kanë qenë objekt i kryerjes së kësaj vepre penale, u marr në kuptim të nenit 92 par. 1 të KPRK-së

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.121/18, me datë 24.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.